| Nr. rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 17.02.2022 | Informacion mbi lëvizjen e shtetasve shqiptar në shtetet e huaja | 17.02.2022 | Referuar kërkesës Tuaj, ju ftoj të ndiqni linkun:<br><br>https://ëëë.punetejashtme.gov.al/informacion-mbi-levizjen-e-shtetasve-shqiptare-ne-shtetet-e-huaja/ | E plotë | Pa tarifë |
| 2. | 18.02.2022 | Informacion në lidhje me aplikim vetëm për kartë identiteti në konsullatë | 18.02.2022 | Në përfaqësitë tona jashtë është rregull që duhen bërë të dy dokumentet biometrike. Nëse dëshironi vetëm njërin prej tyre, duhet të vini të aplikoni në Shqipëri. | E plotë | Pa tarifë |
| 3. | 24.02.2022 | Kërkesë për praktike në MEPJ | 28.02.2022 | Në përgjigje të kërkesës tuaj për zhvillimin e praktikës, pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), ju bëjmë me dije se në zbatim të VKM-së nr. 395, datë 29.04.2015, *‘’Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike’’*, MEPJ bashkëpunon çdo vit me Ministrinë e Arsimit e cila ka rolin e sekretariatit teknik për zbatimin e këtij programi. Në vijim do të vazhdojmë të pranojmë vetëm praktikantët të cilët aplikojnë nëpërmjet këtij programi. | E plotë | Pa tarifë |
| 4. | 03.03.2022 | Informacion se kur mundet një shtetas i huaj të hyjë pa vizë në Shqipëri për vitin 2022 | 04.03.2022 | Nga 1 Maji- 30 Shtator 2022 shtetasit nga Arabia Saudite, Bahrein, Egjipt, Indi, Katar, Oman, Rusi, Tailandë mund të hyjnë pa vizë. | E plotë | Pa tarifë |
| 5. | 03.03.2022 | Informacion mbi qëndrimin e Shqipërisë si shtet anëtarë në këtë mekanizëm të sigurisë, a do të bënit një kërkesë pranë | 07.03.2022 | Që prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Shqipëria ka qenë në vijimësi mbështetësja më aktive në Aleancën Atlantike e domosdoshmërisë që NATO të ketë marrëdhënie institucionale me Kosovën. Në këtë kontekst, Shqipëria pa dyshim që mbështet politikisht kërkesën e Autoriteteve të Kosovës dhe partive të saj | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | organeve të NATO-s që Kosova të pranohet në organizatën më të madhe të sigurisë në botë? | | politike për përshpejtimin e anëtarësimit të saj në NATO.<br>Duke pasur parasysh se kriteret për anëtarësimin në NATO janë të përfshira në Nenin 10 të Traktatit të Uashingtonit, ku theksohet se *"palët, me marrëveshje të njëzëshme, mund të ftojnë për t'u anëtarësuar në këtë Traktat çdo shtet tjetër evropian që është në gjendje të çojë përpara parimet e këtij Traktati dhe të kontribuojë në sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut"*, pengesë kryesore për anëtarësimin e Kosovës në NATO mbetet fakti që katër vende të NATO-s akoma nuk e njohin pavarësinë e Kosovën dhe gjithashtu fakti që çdo vendimmarrje në NATO kërkon domosdoshmërish konsensus të plotë. | | |
| 6. | 14.03.2022 | Kërkesë për hulumtime në Arkivin Historik të MEPJ-së. | 16.03.2022 | Në përgjigje tuajës mbi kërkesën për informacion në lidhje me kërkimin shkencor historik, ju bëjmë me dije se mund të paraqiteni pranë MEPJ-së, ku do bëni një kërkesë të nënshkruar nga ju, gjithashtu Drejtoria përkatëse që mbulon këtë fushë, është lajmëruar dhe ju asiston për më tej. | E plotë | Pa tarifë |
| 7. | 24.03.2022 | Informacion mbi udhëtimin e fëmijës vetëm me njërin prind | 25.03.2022 | Prindi tjetër jep një autorizim për lejimin e udhëtimit të fëmijës me njërin prind. Ky akt përpilohet pranë një noteri ose nëpërmjet e-albania në Ambasadë. | E plotë | Pa tarifë |
| 8. | 24.03.2022 | Kërkesë mbi rolin e Shqipërisë në Kartën e Adriatikut për Kosovën | 29.03.2022 | Pas anëtarësimit të Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO (2009), Shqipëria i ka kushtuar prioritet anëtarësimit të Kosovës në A5, duke përsëritur në mënyrë të vazhdueshme kërkesën që Kosovës t'i mundësohet anëtarësimi me të drejta të plota në Kartë, me argumentin se zgjerimi i anëtarësimit të Kartës, forcon më tej bashkëpunimin në fushën politike dhe të sigurisë mes vendeve të rajonit tonë. Falë përpjekjeve të Shqipërisë u arrit që më 2012, Kosova të ftohet në këtë nismë me statusin e vëzhguesit, megjithëse Karta nuk parasheh status tjetër veç atij të vendit anëtar. Për kundërpeshë vendet anëtare të A-5 ftuan në të njëjtën kohë edhe Serbinë. Aktualisht Kosova, Serbia si dhe | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Sllovenia marrin pjesë në aktivitetet e Kartës si vëzhguese. Anëtarësimi i Kosovës në A5 është penguar deri tani nga Bosnje-Hercegovina, i vetmi vend anëtar i Kartës që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës pasi sipas procedurës së A-5 vendimarrja bëhet me konsesus të plotë.<br>Me nxitjen e palës sonë, Kosova paraqiti zyrtarisht në dhjetor 2014 kërkesën e saj për anëtarësim në Kartën SHBA-Adriatike. Falë insistimit të kryesisë sonë (gjatë vitit 2014) kjo kërkesë u trajtua në takimin e Komisionit të Partneritetit të vendeve të Kartës, të zhvilluar më 15 dhjetor 2014, në Tiranë. Në kundërshtim me mbështetjen pa rezerva që i dhanë anëtarësimit të Kosovës në Kartë, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe SHBA, Bosnje-Hercegovina shkeli premtimin e dhënë që të pranonte anëtarësimin e Kosovës në A-5, duke përdorur marrëveshjen e vitit 2012 mbi përfaqësimin e Kosovës në Organizatat Rajonale, pra me përdorimin e asteriskut. Si pasojë e presionit të Serbisë, pala boshnjake ndryshoi qëndrim duke prishur arritjen e konsensusit dhe duke mos mundësuar anëtarësimin e Kosovës në Kartën SHBA-Adriatike.<br>Pala boshnjake është justifikuar në vijimësi se Karta e Adriatikut nuk përfshihet në listën e Marrëveshjes së nënshkruar në Bruksel në vitin 2012 nga Serbia dhe Kosova. Sipas zyrtarëve të Bosnjës, në rastet kur organizata rajonale nuk përfshihet në këtë listë, atëherë Bosnja dhe Hercegovina merr vendimin në varësi të dakordësisë midis Beogradit dhe Prishtinës, dhe për rastin në fjalë nuk ka një dakordësi, pasi Serbia kundërshton anëtarësimin e Kosovës në A-5.<br>Kjo situatë me bllokimin boshnjak ka vazhduar gjatë 8 viteve të fundit kur pala boshnjake ka vijuar me qëndrimin e saj intransigjent. Ky qëndrim është kundërshtuar ashpër nga pala jonë, duke argumentuar se ai jo vetëm bie ndesh me parimin e dyerve të hapura të Kartës, por | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dëmton kohezionin, solidaritetin dhe efektivitetin e A-5. | | |
| 9. | 31.03.2022 | Informacion mbi mbërritjen e patentës në Shqipëri nga konsullata shqiptare e Milanos | 01.04.2022 | Të gjitha lejet e drejtimit shqiptare që vijnë në MEPJ nëpërmjet ambasadave dhe konsullatave shqiptare, përcillen brenda ditës në DPSHTRR në Tiranë, si autoritet përgjegjës për lëshimin dhe administrimin e tyre. Lutemi të kontaktohet ky autoritet në Tiranë + 355 688015833 ose në adresën: dpshtrr@dpshtrr.gov.al duke dhënë emrin e poseduesit dhe mundësisht edhe numrin e patentës. | E plotë | Pa tarifë |
| 10. | 04.04.2022 | Kërkesë për bashkëpunim mbi përkthimin zyrtar | 04.04.2022 | Bazuar në Ligjin Nr. 82/2021 *"Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar"*, neni 6 pika 1 "Shërbimi i përkthimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë ***kryhet vetëm nga përkthyesit zyrtarë të certifikuar në përputhje me parashikimet e këtij ligji***". Gjithashtu në nenin 7 pika 2 parashikohet se "Profesioni i përkthyesit zyrtar mund të ushtrohet ***vetëm nga personi që është certifikuar për kryerjen e kësaj veprimtarie*** dhe është regjistruar në regjistrin elektronik të përkthyesve zyrtarë në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë ligj". Referuar listës së përditësuar të përkthyesve për vitin 2021 në Ministrinë e Drejtësisë, emri juaj nuk rezulton në listën e përkthyesve zyrtar me certifikatë sigurie dhe as në listën e përkthyesve të jashtëm pa certifikatë sigurie. | E plotë | Pa tarifë |
| 11. | 05.04.2022 | Informacion mbi procesin e depërtimit. | 05.04.2022 | Nëse një shtetas është në proces deportimi, ndaj tij ndiqen procedurat e caktuara sipas protokolleve. Nëse një familjar kërkon informacion më të plotë, mund të drejtohet pranë Autoriteteve Policore dhe të interesohet duke u identifikuar me dokumentacionin përkatës dhe të provoj lidhjen e tij me personin në fjalë. | E plotë | Pa tarifë |
| 12. | 10.04.2022 | Request for asylum | 13.04.2022 | Thank you for addressing us for this issue, but ëe ëould like to inform that in core it is the request for asylum. | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Based on the Laë no. 10/21 "For the Asylum in the Republic of Albania" the request can be submitted by every foreign national or stateless person in the moment of entering in the Albanian territory to the Border and Migration Authority. This is the competent and only authority for identifying, registering and referring to the relevant structure at the Ministry of Interior, then is the Ministry of Interior that verifies and decides if the request fulfill the legal criteria to grant asylum. | | |
| 13. | 13.04.2022 | Kërkesë për informacion lidhur me çështjen nëse Shqipëria ka nënshkruar ndonjë marrëveshje ndërkombëtare mbi falimentin. | 14.04.2022 | Në vijim të kërkesës suaj për informacion mbi listën e marrëveshjeve ndërkombëtare ku Shqipëria mund të ketë aderuar apo nënshkruar në fushën e falimentimit, nga verifikimi i database se marrëveshjeve që disponojmë, nuk na rezulton ndonjë marrëveshje me këtë objekt. | E plotë | Pa tarifë |
| 14. | 21.04.2022 | Aplikim për vizë nga shtetas indian pranë ambasadës RSH Abu Dhabai | 21.04.2022 | Në lidhje me aplikimet e përmendura, aplikantët kanë aplikuar për vizë C për motive profesionale, tregëtare dhe biznesi, me mungesë dokumentacioni ku ju është kërkuar përmes sistemit të bashkëngjisin fotot e aplikantëve sipas formatit të kërkuar si dhe dokumentin që provon aftësinë profesionale, tregtare nga vendi i origjinës, dokumente të cilat nuk i kanë bashkangjitur edhe pas komenteve nga ana e konsullit.<br>Aplikimet sipas të dhënave në sistem janë çelur në datë 19.04.2022 mbas orës 20.00 dhe janë marrë në shqyrtim nga konsulli dt. 20.04.2022 ku dhe janë bërë komentet përkatëse për mungesë dokumentacioni.<br>Gjithsesi, aplikantët, si dhe gjithë aplikantët e tjerë shtetas indian që kanë aplikuar për vizë pranë ambasadës RSH Abu Dhabai, janë njoftuar dje në lidhje me rregullat e reja te udhëtimit në RSH. | E plotë | Pa tarifë |
| 15. | 21.04.2022 | Kërkesë për punësim në MEPJ (shtetas | 21.04.2022 | Employment relations in the Ministry of Europe and Foreign Affairs are regulated by Albanian legislation laë no. 152/2013 "On | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | italian) | | the civil service" ëhich stipulates that civil servants ëho are recruited in the Albanian public administration must be Albanian citizens and have a ëritten and spoken Albanian language. Any other relationship in ëhich a public contract is included betëeen the MFA, a natural person and / or a legal person, is regulated according to the provisions of laë no. 162/2020 "On public procurement". | | |
| 16. | 22.04.2022 | Informacion çfarë ofron shteti shqiptar për shtetasit ukrainas gjatë qëndrimit këtu | 28.04.2022 | Lidhur me kërkesën tuaj për informacion sugjerojmë të konsultoheni me:<br>•VKM nr. 169, datë 18.03.2022, për "Përcaktimin e afatit të hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të Ukrainës në Republikën e Shqipërisë";<br>•VKM nr. 173, datë 18.03.2022, për "Dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve ukrainas, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar mbrojtje ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, si dhe për krijimin e task-forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare" | E plotë | Pa tarifë |
| 17. | 06.05.2022 | 1. Në cilën fazë ndodhet aktualisht çështja e delimitimit të kufirit detar me Greqinë?<br>2. Në cilën fushë është avancuar dhe cilat janë pengesat për të vijuar më tej?<br>Si është përzgjedhur kjo studio ligjore për këshillimin e palës shqiptare për t'u përfaqësuar në Gjykatën e | 06.05.2022 | Të dy qeveritë janë deklaruar se synojnë që të zgjidhin përmes një kompromisi çështjen e delimitimit të zonave të tyre detare nga një palë e tretë gjyqësore, konkretisht Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Qeveria shqiptare është duke ndërmarrë hapat përgatitorë teknike për këtë proces.<br>Në bazë të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën për informim" , MEPJ nuk mund të vërë në dispozicion informacion të klasifikuar në lidhje me konsulencën e nevojshme teknike dhe ligjore për këtë proces përgatitor, ***pasi nuk ekziston asnjë mundësi që ky informacion të deklasifikohen në këtë fazë.***<br>Në të kundërt MEPJ jo vetëm do të cenonte legjislacionin në fuqi por dhe pozitën e palës | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Arbitrazhit në Hagë?<br>Sa i ka kushtuar shtetit shqiptar, kontrata e lidhur me këtë firmë dhe cilat kritere janë marrë parasysh për përzgjedhjen e saj? | | shqiptare në këtë proces delikat për interesat e vendit. | | |
| 18. | 06.05.2022 | (*Kërkesë e përsëritur mbi pararendësen*) Kërkesë mbi Shpjegimin ligjor qe ministria e jashtme e konsideron këtë informacion te klasifikuar, pra ligjin ku bazohet për ta konsideruar "te klasifikuar | 11.05.2022 | <u>Përgjigje e komenteve të parashtrua </u>serish:" Këtë fazë të procesit të marrëdhënieve dypalëshe të gjitha dokumentet trajtohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, *"Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"*, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në varësi të tij. Konkretisht në nenin 6 të tij ligji përcakton klasifikimin e informacionit që lidhet me informacione të qeverive të huaja, marrëdhënie ndërkombëtare ose me veprimtari ndërkombëtare.<br>MEPJ është shprehur në përgjigjen e mëparshme se" *nuk mund të japë informacione të klasifikuara të cilat në këtë fazë të procesit të marrëdhënieve dypalëshe nuk mund të deklasifikohen*.<br>Ky qëndrim i mbajtur nga MEPJ është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" pika 2, germa "a" parashikon që *"2.**E drejta e informimit kufizohet** në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:*<br>*sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni **për informacionin e klasifikuar**;*<br>... Gjithashtu përgjigje e kthyer me pare është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 17 pika 2 gërma "ë" në të cilin ligjvënësi ka parashikuar që' "***<u>e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe</u>*** | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ***<u>të rëndë ndaj interesave në mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare</u>***. Ligjvënësi në ligjin për të drejtën për informim për rastet kur institucioni shtetëror gjendet përballë kërkesës për të deklasifikuar një informacion të klasifikuar ka parashikuar si vijon;<br>"ligj 119/2014, neni 17 pika 5 "<br>… *5.E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara "sekret shtetëror". Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", të ndryshuar. Autoriteti publik njofton menjëherë kërkuesin për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit, sipas ligjit, dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në çdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të kritereve të këtij neni."*<br>Ju bëjmë me dije se në bazë të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", të ndryshuar, dhe VKM, Nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", ***<u>Komisioni për Deklasifikimin, Zhvlerësimin e Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" (KDZH</u>***), ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe ka vendosur se nuk jemi në kushtet që dokumentet të deklasifikohen[1].<br>Sa më sipër të gjitha pyetjet e parashtruara nga Ju lidhen me dokumente të klasifikuara të hartuara dhe administruara në përputhje me ligjin dhe që në këtë fazë të procesit nuk mund të deklasifikohen. [1] Neni 9 Vendimmarrja 1. KDZH-ja merr vendim për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", të prodhuar nga vetë ministria apo institucioni. Përjashtimisht nga | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ky rregull është Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, e cila administron dokumentet e klasifikuara "sekret shtetëror" përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"". 2. Në rastet kur KDZH-ja merr në shqyrtim për deklasifikim informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", të ardhur nga një ministri apo institucion tjetër shtetëror, i kërkon atij pjesëmarrjen e një përfaqësuesi. 3. Gjatë procesit të marrjes në shqyrtim për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" që nuk i përket ministrisë apo institucionit, përfaqësuesi i institucionit të ftuar ka të drejtë të konsultohet me dokumentacionin e marrë në shqyrtim brenda 20 ditëve kalendarike. Afati fillon nga data e marrjes dijeni nga përfaqësuesi i institucionit. 4. Në rast se institucioni i origjinës shprehet kundër deklasifikimit të tij, KDZH-ja nuk duhet ta deklasifikojë dhe/ose zhvlerësojë informacionin e ardhur nga ai. 5. KDZH-ja mblidhet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve dhe merr vendim me shumicën e anëtarëve të pranishëm. 6. Çdo anëtar i KDZH-së ka të drejtën e votës pro ose kundër. 7. Anëtari i cili voton kundër duhet të paraqesë me shkrim arsyet e votimit kundër. 8. Në përfundim të shqyrtimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", të relatuar për deklasifikim, KDZH-ja vendos: a) deklasifikimin e plotë ose deklasifikimin e pjesshëm të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"; b) përjashtimin nga deklasifikimi të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"; 5 c) zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", duke përcaktuar edhe afatin e ri të ruajtjes së klasifikimit. 9. Informacioni i klasifikuar "sekret shtetëror", i përjashtuar nga deklasifikimi, i nënshtrohet rishikimit sistematik për deklasifikim. | | |
| 19. | 09.05.2022 | Sa punonjës ka aktualisht institucioni Juaj dhe si ndahen ata sipas | 17.05.2022 | Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 55, datë 18.03.2022, *"Për disa ndryshime në "Urdhrin nr. 138, datë 21.10.2019 të Kryeministrit, Për miratimin e strukturës dhe* | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | vjetërsisë ne pune? Sa punonjës kane ndjekur trajnime për zhvillimin e mëtejshëm te aftësive, njohurive, njohje me eksperienca dhe praktiken ne institucione te tjera homologe? Sa shpenzoi vitin e shkuar institucioni juaj për trajnime, sa është fondi i planifikuar ketë vit? Keni bere një vlerësim për nevojat e mëtejshme për te rritur kapacitetet e stafit? Sa individë janë larguar nga detyra nga institucioni Juaj vitin e shkuar dhe nëse disponohen cilat janë arsyet (lëvizje paralele, shkarkime). | | *të organikës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”,* të ndryshuar, MEPJ ka 193 punonjës, të cilët, sipas vjetërsisë në punë ndahen, si më poshtë :<br>- Deri në 5 vjet vjetërsi - 47% e punonjësve,<br>- Deri në 10 vjet vjetërsi - 10% e punonjësve,<br>- Mbi 10 vjet vjetërsi - 43% e punonjësve.<br>MEPJ bën çdo vit planifikimin e nevojave për rekrutime të reja, në zbatim të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.<br>Gjatë vitit 2021 janë liruar nga detyra 8 (tetë) punonjës, për arsyet, si më poshtë:<br>- 6 (gjashtë) punonjës janë liruar nga detyra me dorëheqje (5 nga Kabineti i Ministrit dhe 1 punonjës me kërkesën e tij),<br>- 1 (një) punonjës është liruar nga detyra me masë disiplinore, dhe<br>- 1 (një) punonjës është liruar nga detyra për shkak të Ligjit 23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”. | | |
| 20. | 11.05.2022 | 1)Listën me emrat dhe mbiemrat e Konsujve te Nderit qe ka qeveria jashtë Republikës se Shqipërisë?<br>2)Çfarë përfitojnë nga statusi sipas ligjit shqiptar? | 17.05.2022 | Në lidhje me kërkesën Tuaj, ju bëjmë me dije si vijon:<br><br>Sa i përket pikës se pare te kërkesës lutemi konsultohuni me linkun me poshtë: https://punetejashtme.gov.al/ëp-content/uploads/2022/05/Lista-KN-per-ëeb28.03.2022.pdf<br><br>Sqarojmë për piken 2 dhe 3 te kërkesës tuaj qe konsujt e nderit e ushtrojnë ketë funksion vullnetarisht pa asnjë përfitim financiar nga shteti shqiptar.” | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3) A marrin një rroge nga shteti shqiptar? | | | | |
| 21. | 13.05.2022 | Kërkesë nga një studente për të studiuar dokumente në arkivin e MEPJ | 17.05.2022 | Ju duhet të dërgoni me postë ose dorazi në MEPJ një kërkesë në të cilën të prezantoni veten dhe interesin e saj studimor.<br>Gjithashtu, na duhet tema Juaj e studimit dhe periudha kohore e dokumentacionit që ju interesoheni të shfrytëzoni.<br>Në kërkesë gjithashtu të vendosni edhe numrat e kontaktit dhe ne do e kontaktojmë menjëherë për procedurat e mëtejshme. | E plotë | Pa tarifë |
| 22. | 16.05.2022 | Informacion mbi një problem të lindur dje në aeroportin e Rinasit me 2 investitorë indian që kompania jonë ka ftuar për një nga projektet që do të zhvillojë në Qarkun e Korçës.<br><br>Z. Raja Manikandan dhe Z. Sukumar Rajkumar kanë zbritur nga avioni i Beogradit dhe pa arsye nuk janë lejuar të hyjnë në vendin tonë por janë kthyer përsëri në Serbi.<br>Po ju bashkëngjis dokumentet e dy zotërinjve bashkë me disa prej investimeve të tyre si dhe ftesat zyrtare.<br>Duke shpresuar në bashkëpunimin tuaj dhe në zgjidhjen sa më të shpejtë të këtij problemi, nëse është e nevojshme do të | 18.05.2022 | Në vijim të emailit tuaj mëposhtëm, si dhe në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit për të huajt në RSh-në, ju informojmë sa vijon:<br>Sipas përcaktimeve të neneve 6, pika 1, shkronja e, dhe 10, pika 2, të ligjit 79/2021 "Për të huajt", rast pas rasti, të huajit që kërkon të hyjë në kufi, nga autoritetet kufitare mund ti kërkohet dokumentacion shtesë si,<br>– Ftesa e garantit;<br>– Bileta e rezervimit për kthimin e tij;<br>-Çdo dokument që vërteton akomodimin e tij, etj;<br><br>Gjithashtu në rast refuzimi të hyrjes nga ana e autoritetit kufitar, bazuar në nenin 9, pika 3 e ligjit nr. 79/2021 *“Për të huajt”*, i huaji pajiset me një urdhër refuzimi ku shprehet dhe arsyeja e refuzimit të hyrjes.<br>Sa më sipër, bëjmë me dije se ftuesi i shtetasve mund të paraqitet pranë Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Tiranë, për të paraqitur ftesën dhe kërkesën që të mos refuzohet hyrja për investitorët e ftuar prej tij, në rast se plotësojnë kushtet e hyrjes sipas përcaktimeve në ligj. | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shkoj personalisht të udhëtoj me ta për t'i sjellë në Shqipëri. | | | | |
| 23. | 17.05.2022 | Kërkesë për informacion mbi numrin e të rinjve larguar nga Shqipëria 2018-2021. Sa të rinj janë kthyer pas largimit | 26.05.2022 | Deleguar koordinatorit pranë Ministrisë së Brendshme datë 26.05.2022 | E plotë | Pa tarifë |
| 24. | 20.05.2022 | Kërkesën për informacion e Qendrës për Zhvillim dhe Demokratizim të Institucioneve | 20.05.2022 | Përgjigje ezauruese nga Ministria e Drejtësisë<br><br>Deleguar koordinatori datë 20.05.2022 | E plotë | Pa tarifë |
| 25. | 26.05.2022 | 1. Kur ka qenë misioni i fundit i monitorimit të Komitetit të Trashëgimisë Botërore në Butrint?<br>2. A është njohur Komiteti i Trashëgimisë Botërore me draftin për administrimin e ri të Butrintit? Dhe kur saktësisht?<br>3. A është ftuar Komiteti i Trashëgimisë Botërore nga Shteti palë për të vizituar Butrintin, këto dy-tre vitet e fundit? Nëse po, në ç' periudhë | 04.07.2022 | 1. Kur ka qenë misioni i fundit i monitorimit të Komitetit të Trashëgimisë Botërore në Butrint?<br>Komunikimi me Komitetin e Trashëgimisë Botërore (KTB) të UNESCO-s ka qenë dhe mbetet i vazhdueshëm, mbasi interesi i përbashkët është ruajtja dhe përmirësimi i këtij aseti kulturor me vlera kombëtare. Misioni i fundi i monitorimit të UNESCO-s për këtë sit ka qenë vite më parë. Pandemia nuk lejoi zhvillimin e një misioni në dy vitet e fundit. Ndërkohë, komunikimi me agjencitë monitoruese të UNESCO-s dhe KTB ka qenë i vazhdueshëm edhe gjatë periudhës së pandemisë dhe, më pas, deri në ditët e sotme.<br><br>A është njohur Komiteti i Trashëgimisë Botërore me draftin për administrimin e ri të Butrintit? Dhe kur saktësisht?<br><br>Pasuria historiko-kulturore e Butrintit ka qenë dhe mbetet në vemendjen jo vetëm të institucioneve shtetërore, por edhe të “palëve të treta”, të grupimeve të ndryshme, të shoqerisë civile, medias e kështu me radhë. Këto grupime shprehin lirshëm mendimet e | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | tyre, sugjerimet e tyre, për ruajtjen dhe përmirësimin e kësaj trashëgimie kombëtare me vlera ndërkombëtare, tashmë, pjesë e UNESCO-s. Jo rallë ato i drejtohen edhe institucioneve të UNESCO-s për kontestime të ndryshme, për të cilat institucionet e specializuara të shtetit shqiptar kanë detyrimin dhe japin shpjegimet e tyre, bazuar në politikat e UNESCO-s për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë botërore nën mbrojtjen si dhe kuadrit ligjor shqiptar.<br><br>Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë UNESCO-s, përmes Ambasadorit të atëhershëm z. Ferit Hoxha, ka përcjellë në UNESCO me shkresë Nr.20/19, datë 20 Janar 2020, draftin e rishikuar të PMI Butrint.<br><br>2. A është ftuar Komiteti i Trashëgimisë Botërore nga Shteti palë për të vizituar Butrintin, këto dy-tre vitet e fundit? Nëse po, në ç'periudhë?<br>Për shkak të pandemisë globale, nuk ka pas në këto 2-3 vitet e fundit vizita nga institucione të specializuara të UNESCO-s në Butrint. Ndërkohë, komunikimi i institucioneve të UNESCO-s me institucionet e specializuara shqiptare ka vijuar edhe gjatë kësaj periudhe. Gjithsesi, Shqipëria, Butrinti apo edhe sitet e tjera shqiptare që janë pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCO-s, janë të hapura për këdo për ti parë dhe krahasuar me planet e tyre zhvillimore, mbasi si interesi i Shqipërisë ashtu dhe ai i UNESCO-s, janë për ruajtjen dhe promovimin e këtyre vlerave kulturore materiale dhe jo materiale, si pjesë e trashëgimisë kulturore botërore. | | |
| 26. | 29.05.2022 | Informacion mbi Kërkesë për praktikë në MEPJ | 30.05.2022 | Në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme zhvillohen dy programe praktikash çdo vit, si më poshtë:<br>1. Në zbatim të VKM nr. 395, datë 29.04.2015, *‘’Për miratimin e programit* | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike'',* MEPJ bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit, e cila ka rolin e sekretariatit teknik për zbatimin e këtij programi.<br>Praktikë 3-mujore e organizuar nga vetë MEPJ, e cila shpallet në faqen zyrtare: https://punetejashtme.gov.al/<br><br>Në vazhdim MEPJ do të vazhdojë të pranojë vetëm praktikantët, të cilët aplikojnë nëpërmjet këtyre dy programeve. | | |
| 27. | 16.06.2022 | I ëould like to order archival documents at your archive (see attached document) on the 10th July Please find attached the requested document. Can you please confirm that you have received the document and that I can come and visit the archive? Also, can I order the documents before I arrive? And hoë many boxes/documents can I order per day? | 24.06.2022 | To proceed, you must formulate a personal request or that of the institution, if you ëork for that institution, ëhich is addressed to the MFA, the Directorate of the Historical Archive ëhere to express the study interest and the reasons for the use of our diplomatic documentation. Contacts are also placed on request. This request, after you have signed it, scans it and sends it to the address arkivi.historik@mfa.gov.al. Bring the original copy ëith you ëhen you appear at the MFA.<br><br>After receiving a confirmatory response from us, you can appear together ëith your identification document and use the archive files ordered in our Study Room. The fee for a photocopied document sheet is 100 lek / sheet for foreigners, ëhile for a photo 20 lek / sheet. Payment is made in the bank on behalf of the MFA.<br><br>July 11 (Monday) is Ok, as archival usage has no interruptions throughout the summer.<br><br>Ëe confirm receipt of the introductory letter from Fudan University on the research interest of Mr. Grundy. It ëas protocol.<br>You can come to the MFA / Historical Archive-Study Room on July 12, as July 11 is a holiday due to the Eid holiday. | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | You can appear in our premises in the period 1-5 August. The staff is available.<br><br>The files are served ëith a rule of five files. As soon as you finish the first five, you get another five. There is no daily limit on the use of files. The files requested are fully accessible. If there is classified material, i.e. remaining such after the declassification process, that material is not served. | | |
| 28. | 21.06.2022 | Kërkoj nga ana juaj informacionin si vijon:<br>Dosjen e plote për z. P.K nga momenti i mbërritjes se dekretit te emërimit nga Presidenti, datën kur është paraqitur ne detyre, datën kur ka filluar pagesa e pagës dhe detyrimeve shëndetësore dhe shoqërore deri ne momentin e lirimit nga detyra si ambasador ne Pakistan dhe ne Bullgari.<br><br>Ne ketë dosje, lutem te përfshihen dhe pagat, pagesa e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore për z P. K.<br>Pagesa e detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore edhe për bashkëshorten e ambasadorit, M. K. | 05.07.2022 | Në vijim të kërkesës suaj, bashkëlidhur ju përcjellim një kopje të skanuar të dokumenteve të nxjerra nga dosja e personelit të z. P. K, si më poshtë:<br><br>Vendim nr. 332, datë 22.11.1995, të Ministrit të Punëve të Jashtme, lidhur me marrjen e detyrës së z. K.. në Islamabad, në Pakistan;<br>Dekret nr. 2243, datë 02.11.1998, të Presidentit të Republikës, "Për lirimin e z. P. K nga detyra Ambasador në Republikën Islamike të Pakistanit";<br>Dekret nr. 6772, datë 15.11.2010, të Presidentit të Republikës, "Për emërimin e z. P. K Ambasador, në Republikën e Bullgarisë";<br>Dekret nr. 8483, datë 10.02.2014, të Presidentit të Republikës, "Për lirimin e z. P. K nga detyra Ambasador në Republikën e Bullgarisë".<br><br>Pagat e z. P. K, për periudhën që ka punuar në përfaqësi diplomatike, kanë qenë si vijon:<br>Ne Ambasadën e RSh-së në Islamabad, në Pakistan: 770 USD<br>Ne Ambasadën e RSH-së në Sofje, në Bullgari:<br>në periudhën janar 2011 deri më 1 gusht 2013 paga e Ambasadorit ka qenë bruto 2,338 euro dhe neto 1,994 euro<br>në periudhën 1 gusht 2013 deri më 1 gusht 2014 paga e Ambasadorit ka qenë bruto 2,381 euro dhe neto 1,996 euro | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - në periudhën 1 gusht 2014 deri më 21 mars 2014 paga e Ambasadorit ka qenë bruto 2,014 euro dhe neto 1,777 euro | | |
| 29. | 12.07.2022 | Artan Rama- Kërkesë mbi sqarimet që Ministria e Kulturës i ka përcjellë QTB nëpërmjet Misionit të Përhershëm | 13.07.2022 | Deleguar koordinatori datë<br><br>13.07.2022 | E plotë | Pa tarifë |
| 30. | 02.08.2022 | Informacion zyrtar a është e lejuar të transportohen zhdoganohen, dhe instalohen domain govt.al server dhe pajisjeve elektronike të cilat UNOPS do prokurojë dhe dhurojë shtetit shqiptar, të cilat kanë certifikatën e vendit të origjinës Rusinë. | 08.08.2022 | Sanksionet ndaj Federatës Ruse për kategorinë e mallrave të përmendur janë mbi eksportin e këtyre mallrave drejt Rusisë.<br>Për sa i përket importit, me VKM-në nr. 292, datë 11.05.20222, RSH është li njëzuar me vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/578: Neni 4k, pika 1. “Ndalohet blerja, importimi ose transferimi, drejtpërdrejtë ose indirekt, i mallrave që gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme për Rusinë, duke mundësuar kështu veprimet e saj që destabilizojnë situatën në Ukrahinë në Bashkimin, nëse ato janë me origjinë nga Rusia ose eksportohet nga Rusia”.<br>Mbetet për tu vlerësuar nëse prokurimi i këtyre pajisjeve do të gjeneronte të ardhura të konsiderueshme për Rusinë. | E plotë | Pa tarifë |
| 31. | 05.08.2022 | Koordinatori i MM ka deleguar kërkesën për informacion të z. A. M për instalimin e një bazë të re navale të NATO-s në portin e ri të Porto Romanos. | 10.08.2022 | Ne përgjigje te kërkesës tuaj ju bëjmë me dije si vijon:<br>Në tërësi e gjithë përmbajtja e pyetjeve lidhet me kapacitetin mbrojtës dhe marrëdhënieve me Nato-n të cilat janë jashtë fushës së veprimtarisë së MEPJ-së.<br>MEPJ, ju informon se me datë 13 korrik 2022, Kryeministri Edi Rama diskutoi në një takim të posaçëm me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s idenë e palës shqiptare për bashkëfinancim më Nato-n të një aneksi ushtarak, që qeveria shqiptare projektin ta ndërtojë portin e ri tregtar të Porto Romanos.<br>Kryeministri Rama, u shpreh publikisht se vlerësonte shumë disponibilitetin e Sekretarit të Përgjithshëm për të trajtuar në bisedë ambicien e vednit tonë për të shtuar një vlerë | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | tjetër të rëndësishme në infrastrukturën dhe logjistikën e NATO-s, duke vënë ën dispozicion të aleancës Atlantike një bazë të flotës detare të fjalës së fundit, e cila mund të ndërtohet duke pasur parasysh sfidat e kohës sonë.<br>Në përfundim, MEPJ është plotësisht e gatshme të mbështesë në vijimësi të gjitha aspektet politike të ndërveprimit tonë me Nato-n, lidhur me këtë nismë të rëndësishme të vendit tonë në kuadër të sigurisë së përbashkët të territorit të Aleancës Atlantike. | | |
| 32. | 24.08.2022 | Informacion mbi raportet e auditit vitet.2007, 2008, 2009. | 30.8.2022 | Në përgjigje të kërkesës tuaj, mbi ankesën e z. A.M ju bëjmë me dije si vijon: Informacioni i kërkuar ndodhet pranë Dr. Arkivit ne MEPJ. Bazuar ne ligjin 9154/2003, neni 61, pika 2, "Dokumentet qe administrohen ne institucionet e arkivore shtetërore, jepen për shfrytëzim pasi kane kaluar 25 vjet nga data e krijimit". Ne këto kushte, kur nga krijimi i dok. Te kërkuara nuk ka kaluar 25 vjet, këto dokumente nuk mund te vihen ne dispozicion | E plotë | Pa tarifë |
| 33. | 26.08.2022 | Info ne lidhje me emërimin e znj. I.D drejtore e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve pranë MEPJ-se, shoqëruar me: Kopje te urdhrit te znj. I.D drejtore e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve pranë MEPJ, shoqëruar me arsyetimin e emërimit ne kohen qe kishte mbushur moshën e pensionit, si dhe me arsyet se perse asnjë nëpunës tj i administratës shtetërore apo i MEPJ ne moshën active nuk u emërua ne ketë detyre. | 19.09.2022 | Ne lidhje me kërkesën Tuaj, ju bëjmë me dije si vijon:<br>*Znj. I.D është riemëruar në detyrën Drejtore e Përgjithshme Ekon eksperiencë së saj shumëvjeçare në këtë pozicion edhe në vitet e m për nevoja pune dhe nuk ka sjellë kosto të shtuar financiare për inst Pozicioni Drejtori i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme Ek Urdhrin nr.138, datë 21.10.2019, "Për miratimin e strukturës dhe t Jashtme", të ndryshuar, është me status diplomat. Znj. Ilda Dega m Z. G. T është emëruar në detyrën Sekretar i Përgjithshëm i MEPJ n e jashtëm të RSH-së" dhe VKM-në nr. 816, datë 07.10.2015, "Për r*<br>*Bashkëlidhur kopje e gjithë dokumentacionit lidhur me emërimi Përgjithshëm i MEPJ-së.*<br>*Sa më sipër, kriteret për përzgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm Punët e Jashtme, si dhe të gjithë stafit të përfaqësive diplomatike pa jashtëm të Republikës së Shqipërisë" dhe VKM-në nr.816, datë 07.10 e Jashtëm".*<br>*Emërimi i diplomatëve në misione diplomatike dhe poste konsullor në Kreun III dhe Kreun V, të Ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e j VII, të VKM-së nr. 816, datë 07.10.2015, "Për miratimin e Rregullo*<br>Bashkëlidhur materialet (scan). | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kopje te shkresave te ardhura nga KMSHC, date e prot ne MEPJ, personat qe kane trajtuar shkresat si dhe përgjigjen qe i është kthyer KMSHC.<br><br>Autoriteti qe ka urdhëruar vijimin e karrierës se nëpunësit ne moshe pensioni znj. I.D bazën ligjore ku është mbështetur, si dhe me analizën e kostos financiare qe ky emërim i sjell buxhetit te shtetit.<br><br>Informacion ne lidhje me përzgjedhjen e z. G.T ne postin e SP ne MEPJ, shoqëruar me:<br><br>Kopje te akteve proceduriale te përzgjedhjes se SP te MEPJ z. G.T.<br><br>Kopje te platformës se parashtruar nga SP z. G.T përpara stafit te MEPJ gjate fazës se kandidimit.<br><br>Kopje te akteve te njoftimit te kësaj platforme te stafit ne MEPJ. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Informacion ne lidhje me kriteret e përzgjedhjes se Drejtorit te Përgjithshëm te MEPJ shoqëruar me shpjegime qe hedhin drite mbi sa me poshtë:<br><br>A ekziston ndonjë dokument zyrtar qe përcakton kriteret e përzgjedhjes se SP te MEPJ, nëse po, lutem te me përcillni një kopje te tij.<br><br>Emërimi ne postin e Drejtorit te Përgjithshëm te MEPJ, është fryt i konkurrimit apo i emërimit ex cathedra? Ne rast se është ex cathedra, lutem te me përcillni bazën ligjore ne te cilën mbështetet kjo forme emërimi, si dhe autoritetin emërues.<br><br>Procedurat e emërimit ne postet diplomatike jashtë vendit, sidomos sa i përket aspektit te përmendur ne piken (b) shprehimisht, nëse emërimi ne | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | postet diplomatike jashtë vendit është fryt konkurimi, apo emërimi ex chathedra, dhe ne ketë rast te fundit, lutem te me përcillni bazën ligjore ne te cilën mbështetet kjo forme emërimi, si dhe autoritetin emërues. | | | | |
| 34. | 29.08.2022 | Kontratën e lidhur nga Ministria e Jashtme me objekt konsulencë për hartimin e projektmarrëveshjes që do të lidhet ndërmjet RSH dhe asaj te Greqisë, për referimin e çështjes së kufizimit të zonave detare pranë Gjykatës ndërkombëtare të Drejtësisë, bazuar ne VKM nr. 224, datë 7.04.2021 "Për miratimin e kontratës me objekt konsulencë për hartimin e projektmarrëveshjes që do te lidhet ndërmjet RSH dhe asaj të Greqisë, për | 07.09.2022 | Ne përgjigje Tuajes lidhur me informacionin mbi:<br>*Kontratën e lidhur nga Ministria e Jashtme me objekt konsulence për hartimin e projektmarrëveshjes qe do te lidhet ndërmjet RSH dhe asaj te Greqisë, për referimin e çështjes se kufizimit te zonave detare pranë Gjykatës ndërkombëtare te Drejtësisë, bazuar ne VKM nr. 224, datë 7.04.2021 "Per miratimin e kontratës me objekt konsulence për hartimin e projektmarrëveshjes qe do te lidhet ndërmjet RSH dhe asaj te Greqisë, për referimin e çështjes se kufizimit te zonave detare pranë Gjykatës* ndërkombëtare te Drejtësisë", ju bëjmë me dije si vijon:<br>Autoriteti publik (MEPJ) informon se dokumentet te cilat ju kërkoni ne baze te ligjit nr. 119/2014 "Për te drejtën e informimit" janë akte te cilat janë hartuar dhe administrohen në bazë të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror".<br>Sa më sipër mbështetur në pikën 2/a të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*" MEPJ nuk mund të vërë në dispozicion informacionin e kërkuar nga ana e kërkueses. | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | referimin e çështjes së kufizimit të zonave detare pranë Gjykatës ndërkombëtare të Drejtësisë | | | | |
| 35. | 30.08.2022 | Informacion ne lidhje me punësimin nëpër Ambasada/Konsullata | 15.09.2022 | Punësimi në personelin e Shërbimit të Jashtëm, bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Ligjin nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", dhe në përputhje me Ligjin nr. 23/2015 "Për Shërbimin e Jashtëm të RSH-së". Procedura e pranimit/rekrutimit në shërbimin civil, realizohet nëpërmjet konkurrimit të hapur, e cila organizohet dhe ndiqet deri në përfundim, me sistemimin e aplikantit nga Departamenti i Administratës Publike (DAP), që është njësia përgjegjëse për institucionet e administratës publike. Faqja zyrtare e DAP-it, ku pasqyrohen vendet vakante është: https://ëëë.dap.gov.al/.<br><br>Lidhur me mundësinë e punësimit në përfaqësitë e RSH-së, si personel administrativ, teknik, apo i shërbimit, duhet të aplikohet pranë përfaqësive për vendet vakante të kësaj kategorie. | E plotë | Pa tarifë |
| 36. | 23.09.2022 | 1. Kur ka qënë misioni i fundit i Komitetit të Trashëgimisë Botërore apo i ICOMOS për Sitin, që ka vizituar Sqipërinë?<br>2. Kur ka qënë letra e fundit që Komiteti i Trashëgimisë Botërore i ka dërguar qeverisë shqiptare, lidhur me Sitin? | 12.10.2022 | Në përgjigje Tuajës Ju bëjmë me dije si vijon: Misioni i fundit i zhvilluar nga UNESCO ne Butrint ka qene ne muajin prill 2007.<br><br>- Ne vijim, sqarojme se Komiteti i Trashegimise Boterore nuk i dergon letra shtetit pale por miraton vendime. Vendimi I fundit eshte miratuar ne 2009. Eshte Qendra e Trashegimise Boterore e cila i dergon letra institucioneve kombetare te interesuara.<br>Letra e fundit mban daten 29 shtator 2022 lidhur me Misionin Keshillues te Perbashket te QTB dhe ICOMOS me ane te se ciles Ministrja e Kultures Margariti e fton per te vizituar Butrintin. | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Sjellim ne vemendje se i gjithe informacioni ne lidhje me dy pyetjet e lartpermendura dhe me gjere per kete ceshtje gjendet lirisht ne ëebsite te UNESCOs https://ëhc.unesco.org/en/list/570/ | | |
| 37. | 29.09.2022 | 1. Kopje të Rregullores së Brendshme të Ministrisë Për Evropën dhe Punët e Jashtme. 2. Kopje të Rregullores për mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi Autoritetin Publik MEPJ. 3. Kopje të akteve administrative që përmbajnë tregues të performancës së Autoritetit Publik MEPJ. 4. Të dhëna për buxhetin e miratuar dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2022, për ambasadat e RSH-së në Abu Dabi, Kuvajt, Katar, Rusi, Bruksel, Londër, Nju Jork, Kanada, Misioni i Posaçëm Ukrainë, Konsullata e Përgjithshme Bari, Konsullata e Përgjithshme | 26.10.2022 | Në përgjigje tuajës, në lidhje me sa kërkoni ju bëjmë me dije si vijon: Nisur nga historiku në të cilën ju i drejtoheni vazhdimisht MEPJ-së me kërkesa për informacion me objekte të ndryshme, si një e drejtë e parashikuar nga Kushtetuta, aktet ndërkombëtare dhe ligjet ne fuqi, MEPJ ju ka mundësuar aksesin e njohjes së informacionit brenda fushës së kompetencës dhe materialeve që disponon MEPJ konstaton se informacionet e dhëna janë keqpërdorur me qëllimin mediatik për të bërë lajme me nocion fyes ndaj Institucionit.<br><br>Referuar ligjit në fuqi, parimeve të përgjithshme dhe jurisprudencës ndërkombëtare mbi të drejtën për informim, ushtrimi i kësaj të drejte nuk duhet të përbëjë abuzim, duke e vendosur kështu institucionin në një vështirësi dhe mbingarkesë përballë ushtrimit të legjitimitetit tuaj si kërkues, si dhe në marrëdhënie të vështirë me shtetet e tjera. Cenimi i imazhit të MEPJ është njëkohësisht cenim i imazhit të Republikës së Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.<br><br>Në këtë linjë, duke ju dhënë njëkohësisht përgjigje edhe mbi kërkesën Tuaj të datës 14.10.2022, ju bëjmë me dije se MEPJ gjendet në kushtet e nenit 17 pika” ç” e ligjit “Për të drejtën e Informimit” në të cilën përkufizohet se:<br><br>*.....E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:* | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Selanik, Konsullata e Përgjithshme Milano, Konsullata e Përgjithshme Mynih, Konsullata e Përgjithshme Janinë, Konsullata e Përgjithshme Stamboll. 5. Kopje të akteve administrative të transfertave të kryera nga MEPJ në drejtim të përfaqësive të cituara në pikën 4 nga Janari 2022 deri në 01.10.2022. 6. Kopje të akteve administrative të përzgjedhjes dhe ngritjes së Komisioneve të Karrierës Diplomatike në vitet 2019, 2020, 2021, 2022. Kopje të akteve administrative të hartuara nga këto Komisione për dhënien e gradave diplomatike. 7. Kopje të vendimit të Këshillit të Ministrave për çeljen e Misionit të Posaçëm RSH-së në Ukrainë dhe informacion mbi | | ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;<br><br>Duke qenë se MEPJ është subjekt auditimi nga institucionet përkatëse, dhënia e informacionit në këto momente dëmton mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit dhe për këtë arsye nuk mund të vihet në dispozicion aktualisht. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | statusin aktual të këtij misioni. 8. Kopje të aktit administrativ të emërimit znj. I. M Kryetare e Task Forcës së Kryesisë Shqiptare të OSBE-së. 9. Statusin e nëpunësve të Task Forcës së Kryesisë Shqiptare të OSBE-së mbas përfundimit të mandatit të kësaj kryesie duke më vënë në dispozicion aktet e lirimit/emërimit në MEPJ dhe pagat që ata kanë marrë për pozicionet ku janë emëruar që nga momenti që ka mbaruar mandati i kryesisë. 10. Kopje të shpenzimeve të kryera nga MEPJ për Kryesinë shqiptare të OSBE-së. 11. Kopje të akteve të verifikimit pranë autoritetit të dosjeve të figurës së diplomatëve dhe funksionarëve të MEPJ të emëruar nga viti 2017 deri në vitin 2022 sipas parashikimeve të | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nenit 35, të ligjit 23/2015. | | | | |
| 38. | 04.10.2022 | Informacion ne lidhje me VKM-të e miratuara me propozim të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme **Nr.17/13.1.22** "Për disa ndryshime në vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar" **Nr.66/2.2.22** "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese | 17.10.2022 | Ne përgjigje Tuajes për sa kërkoni, MEPJ ju bën me dije si vijon<br><br>"Ne mbështetje te ligjit nr. 9000, date 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit te Ministrave" dhe akteve nënligjore ne zbatim te tij, përcaktohet se, projekt aktet se bashku me relacionin shoqërues depozitohen ne Këshillin e Ministrave për miratim". | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar"<br>**Nr.91/9.2.22** "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024"<br>**Nr.92/9.2.22** "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar**"**<br>**Nr.106/27.2.22** "Për ndalimine fluturimeve ajrore nga transportuesit ajrorë rusë në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë"<br>**Nr.123/2.3.22** "Për disa shtesa në vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar"<br>**Nr.124/2.3.22** "Për përcaktimin e afatit të hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë"<br>**Nr.125/2.3.22** "Për disa ndryshime në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e ceremonialit shtetëror të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"<br>**Nr.157/11.3.22** "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar” **Nr.168/18.3.22** “Për disa shtesa në vendimin nr.1128 datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar” **Nr.169/18.3.22** “Për përcaktimin e afatit të hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të Ukrainës në Republikën e Shqipërisë” **Nr.173/18.3.22** “Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve ukrainas, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar mbrojtje ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë si dhe për krijimin e Task- | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare.<br>**Nr.187/30.3.22** "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar"<br>**Nr.200/6.4.22** "Për disa shtesa në vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar"<br>**Nr.215/13.4.22** "Për disa shtesa në | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar” **Nr.243/20.4.22** “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë” | | | | |
| 39. | 10.10.2022 | Kërkesë për informacion mbi VKM-të e miratuara me propozim të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme Nr.292/11.5.22 “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, | 25.10.2022 | Ne lidhje me kërkesën tuaj me te njëjtin objekt kërkimi sa i takon vënies ne dispozicion te relacioneve qe kane shoqëruar aktet e propozuara nga MEPJ, lutemi te adresoni kërkesën Tuaj pranë Këshillit te Ministrave për te marre informacionin dhe aktet e kërkuara. | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, Nr.341/26.5.22 “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar” Nr.373/1.6.22 “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar" Nr.406/10.6.22 "Për dhënie ndihme financiare humanitare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e qeverisë së Ukrainës" Nr.413/15.6.22 "Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar" Nr.448/29.6.22 "Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar"<br>Nr.527/29.7.22 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar"<br>Nr.528/29.7.22 "Për një shtesë në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e ceremonialit shtetëror në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"<br>Nr.570/25.8.22 "Për një shtesë në vendimin nr. 501, datë 25.8.2021, të Këshillit të | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ministrave, “Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve afganë dhe personave pa shtetësi, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën Islamike të Afganistanit, dhe për krijimin e task-forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare” Nr.631/28.9.22 “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar” | | | | |
| 40. | 12.10.2022 | A ka një drejtori IT-je ministria? Nëse po më vini në dispozicion të | 13.10.2022 | Deleguar për trajtim koordinatorit të AKSHI-t. | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhënat për drejtorinë përkatëse.<br><br>Nëse jo, ju lutem më vini në dispozicion arsyet pse nuk ka një drejtori të tillë në Ministrinë tuaj?<br><br>Cilat kanë qenë investimet në sigurinë kibernetike në 5 vitet e fundit? | | | | |
| 41. | 15.10.2022 | Sa marrëveshje të tilla janë nënshkruar nga institucioni juaj dhe cilat janë ato?<br><br>2. Sa prej tyre janë realizuar plotësisht dhe cilat janë?<br><br>3. Sa prej tyre janë realizuar pjesërisht dhe cilat janë?<br><br>4. Sa prej tyre nuk kanë nisur ende të realizohen dhe cilat janë? | 28.10.2022 | Në përgjigje tuajës, ku kërkoni informacion lidhur me marrëveshjet e nënshkruara Shqipëri - Kosovë në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ju informojmë mbi zbatimin e tyre, si më poshtë:<br><br>Dokumenti politik që ka institucionalizuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin dypalësh në mënyrë kapilare mes dy vendeve tona është Deklarata e Përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, e vitit 2014, e cila përfshihen këto fusha kryesore:<br><br>§ Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë;<br><br>§ Drejtësinë dhe Çështjet e brendshme;<br><br>§ Ekonominë, Energjinë, Transportin, Turizmin dhe Mbrojtjen e Mjedisit;<br><br>§ Kulturën, Arsimin dhe Shkencën.<br><br>Mbi bazën e deklaratës është materializuar bashkëpunimi mes dy vendeve tona, me një tërësi marrëveshjesh konkrete në të gjitha fushat, sipas katër pikave që përmban deklarata, gjatë mbledhjeve të përbashkëta të dy qeverive. Marrëveshjet në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Jashtme përfshijnë bashkëpunimin në kuadër të | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | politikës së jashtme, anëtarësimit në BE, diasporës dhe ofrimit të shërbimeve konsullore. Marrëveshjet në fushën e politikës së jashtme kanë si qëllim forcimin e bashkëpunimit në fushën e politikës së jashtme, duke ngritur dhe konsoliduar mekanizmat që forcojnë këtë bashkëpunim dhe mirë administrojnë burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore. Ndër të tjera, Republika e Shqipërisë merr detyrime konkrete në prezantim, mbrojtje dhe afirmim të qëndrimeve politike të Republikës së Kosovës në të gjitha rastet ku pjesëmarrja e kësaj të fundit është e pamundur për shkaqe objektive. Për më shumë, Shqipëria ka ndërmarrë një fushatë të veçantë në funksion të zgjerimit të njohjes së Kosovës në rrafshin ndërkombëtar. Në janar 2022, në Prizren u themelua Këshilli i Përbashkët për Planifikim Strategjik, me qëllim përcaktimin e prioriteteve dhe qëndrimeve të përbashkëta të rëndësisë kombëtare në fushën e politikës së jashtme dhe diplomacisë për një periudhë afatgjatë. Marrëveshja ndërmjet Akademive Diplomatike, sqarojmë se në kuadër të zbatimit të Memorandumit mes dy Akademive Diplomatike të Ministrive të Punëve të Jashtme, janë zhvilluar takime periodike (të paktën 2 herë në vit) mes Drejtorëve të Akademive Diplomatike, me synim koordinimin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, përafrimin e moduleve të trajnimit, etj. Në aktivitetet trajnuese të organizuara nga Akademitë respektive diplomatike ka pasur pjesëmarrës dhe folës nga ty dy vendet. Gjithashtu, janë organizuara aktivitete të përbashkëta, si prsh., Seminari për Sigurinë në rajonin e Evropës Juglindore - 22-24.06.2022, në Durrës. Marrëveshjet në fushën e bashkëpunimit konsullor kanë si qëllim angazhimin në përfaqësimin konsullor të ndërsjellë, në ato shtete ku njëri prej vendeve nuk ka përfaqësim. Nga pikëpamja diplomatike, marrëveshja inicion ngritjen e "fondit të përbashkët për menaxhimin, ngritjen dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | zhvillimin e ambasadave, misioneve dhe konsullatave", me qëllim krijimin e hapësirave për përdorim të përbashkët nga dy vendet. Kanë gjetur zbatim të pjesshëm, duke hasur si pengesë kryesore vendet pritëse, që nuk kanë pranuar përfaqësim të përbashkët. Aktualisht funksionon përfaqësimi konsullor në godinat e përbashkëta, në Milano (Itali), Mynih (Gjermani), Kopenhagen (Danimarkë) dhe Kanberra (Australi), megjithatë vijohet të punohet për një shtrirje më të gjerë. Referuar përfaqësimit konsullore në Strugë, mund të themi se është një nga shembujt e përfaqësimit tonë të përbashkët Shqipëri-Kosovë. Procedurat e pranimit janë mbyllur dhe po punohet për dërgimin e personelit konsullor. Marrëveshjet në fushën e bashkëpunimit për diasporën, disa nga të cilat kanë kaluar në kompetencë të MEPJ, me vendimin nr.81, datë 9.2.2022 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme", sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për Diasporën. Marrëveshjet e kësaj natyre synojnë të rrisin bashkëpunimin përmes institucioneve përkatëse kulturore, arsimore dhe shoqatave e individëve në diasporë, si dhe të ofrojnë ndihmën e tyre në menaxhimin e qendrave të përbashkëta kulturore. Palët angazhohen për të mbështetur bashkëpunimin për veprimtaritë e trashëgimisë kulturore, aktivitetet muzeore, galerive, folklorit dhe aktiviteteve të tjera. Në kuadër të implementimit të Protokollit të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës, Shqipëria dhe Kosova organizuan së bashku "Colours of Albanians 2022". Një tjetër arritje e këtij bashkëpunimi është edhe dakordësimi për një tekst të përbashkët Shqipëri-Kosovë "Gjuha shqiptare dhe Kultura shqiptare niveli 1", i cili u miratua nga nga të dy palët në shtator 2021. Këte vit arsimor 2022-2023, tekstet shqip i shpërndarë në diasporë është | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përbashkët. Nderkohe puna vazhdon për të miratuar Nivelin 2 dhe Nivelin 3 të këtij teksti.<br><br>Gjithashtu, kuadri ligjor mes dy ministrive të jashtme ka gjetur zbatim në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta nga perfaqesitë diplomatike të dy vendeve sic janë Festat e përbashkëta kombëtare, apo aktivitetet me karakter kulturor ekonomik, turistik etj., Po punohet për ngritjen e qendrave të përbashketa kulturore. Nderkohë një Qendër Kulturore e perbashket është hapur në Ankara, Turqi dhe menaxhohet nga të dy Ambasadat, ajo e Shqiperise dhe Kosoves. Marrëveshjet në fushën e bashkëpunimit në kuadër të anëtarësimit në BE. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, e viti 2017 zbatohet për fushën e përkthimit të acquis të BE-së dhe certifikimit të përkthimit.<br><br>Duke qenë se Shqipëria në mars 2020 mori vendimin pozitiv të Këshillit për hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE, me synim për të reflektuar këtë angazhim të ri, i propozoi palës kosovare një marrëveshje të re më specifike për mbështetjen e ndërsjelltë në kuadër të përgatitjes për hapjen e negociatave të pranimit, që u nënshkrua në prill 2020.. Palët bashkëpunojnë në këto fusha të interesit të përbashkët:<br><br>· Shkëmbimin e përvojës në fushën e procesit të integrimit evropian, në procesin e negociatave të anëtarësimit në BE, vecanërisht duke u përqëndruar në: I. Krijimin e strukturave negociuese për bisedimet e anëtarësimit; II. Funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës në kuadër të kapitujve të negociatave të anëtarësimit; III. Shkëmbimin e informacionit dhe përvojës përsa i përket procesit të shqyrtimit analitik të legjislacionit ('screening'); | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | · Thellimin e dialogut politik mes dy Ministrive me qëllim bashkërendimin e qëndrimeve institucionale në shërbim të procesit të integrimit evropian duke organizuar Konferencën e përbashkët vjetore të dy Ministrive për çështje të integrimit evropian. Me mbajtjen nga Shqipëria të Konferencës së parë Ndërqeveritare për nisjen e negociatave të anëtarësimit në BE me 19 korrik 2022 dhe me vendosjen e Ministres së Shtetit/Kryenegociatores Majlinda Dhuka, u realizua edhe takimi i parë me palën kosovare për shkëmbim përvoje lidhur me procesin për anëtarësim në Bashkimin Evropian midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë me 30 shtator 2022, në Tiranë. Takimi shërbeu për të shkëmbyer experiencat në lidhje me vizionin dhe sfidat e procesit te integrimit evropian të të dy vendeve, strukturat institucionale, etj , si dhe palës kosovare iu dha përvoja jonë e aplikimit të anëtarësimit në BE. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Integrimit Evropian të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Integrimit Evropian të Republikës së Kosovës për krijimin e Komisionit Teknik për përkthimin e legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe, si dhe bashkëpunimit në sferën e përafrimit të legjislacionit, ndër të tjera, parashikon:<br><br>· themelimin e Komisionit Teknik që ka kompetencë përcaktimin dhe koordinimin e kalendarit vjetor të legjislacionit të BE-së që duhet të përkthehet në gjuhën shqipe,<br><br>· përcaktimin e procedurave të unifikuara të përkthimit dhe verifikimit të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe, dhe;<br><br>· certifikimin e versioneve përfundimtare të akteve të përkthyera në gjuhën shqipe.<br><br>Thellimi i bashkëpunimit në procesin e përkthimit dhe rishikimit të përkthimit të acquis së BE-së në gjuhën shqipe, përmes | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përdorimit të teknologjisë moderne të unifikuar është objekt, ndër të tjera, edhe i nenit 2 "Fushat e bashkëpunimit" të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në kuadër të anëtarësimit në BE. Bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në këtë fushë është unik dhe ka rezultuar i frytshëm, ku ndër të tjera veçojmë përpilimin e manualit për përkthimin e legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe, si dhe bazën e të dhënave për publikimin e akteve ligjore të përkthyera. Aktualisht Komisioni i përbashkët Teknik funksionon duke u mbledhur 4 herë në vit. Kryhen vazhdimisht bashkërendim mbi kalendarët e përkthimit, që të mos ketë përsëritje për legjislacionin që përkthehet në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Ndër arritjet ndër vite të Komisionit Teknik përmendim:<br><br>· faqen ëeb (https://albterm.net/ ) ku janë ngarkuar të gjitha aktet që janë përkthyer për të dy shtetet;<br><br>· manualin për përkthimin e Legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe. Realizimi i këtij manuali u mundësua nga koordinimi efikas i anëtarëve të Komisionit Teknik i të dyja vendeve, Ministria e Integrimit Evropian (RKS) dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (RSH).<br><br>Komisioni i përbashkët Teknik po punon për projektin pilot për një "Manual tjetër të Certifikimit të legjislacionit". Në vazhdimësi synohet që:<br><br>· të aplikohet qasja e integruar e koordinimit, planifikimit, dhe raportimit lidhur me përkthimin dhe certifikimin e acquis së BE-së në gjuhën shqipe, në të dy vendet;<br><br>· të bëhet planifikimi i hershëm për përkthimin e acquis së BE-së, veçanërisht përditësimi i acquis në PKIE-RSH dhe PKZMSA-RKS; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | · të përditësohet platforma elektronike ëëë.albterm.net me acquis të përkthyer dhe të certifikuar deri më tani, nga kalendari i përkthimit 2021;<br><br>· të krijohet një bazë e përbashkët të Terminologjisë së BE-së në Gjuhën Shqipe dhe vendosja në platformën elektronike ëëë.albterm.net;<br><br>· të hartohet Manuali i Përbashkët për Certifikimin e acquis në Gjuhën Shqipe, përmes asistencës së projekteve që mbështesin procesin e integrimit Evropian në Kosovë. LISTA E MARRËVESHJEVE TË NËNSHKRUARA SHQIPËRI - KOSOVË27.10.2022<br><br>1. Protokoll veprimi ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës për përfaqësimin konsullor të Republikës së Shqipërisë në Strugë, Maqedoni e Veriut, nënshkruar dhe hyrë në fuqi më 4.12.2020.<br><br>2. Marrëveshje ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës për ngritjen e grupit të punës për krijimin e fondit të përbashkët në mbështetje të shqiptarëve në Mal të Zi”, nënshkruar dhe hyrë në fuqi më 4.12.2020.<br><br>3. Marrëveshje ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Republikës së Kosovës për ngritjen e grupit të punës për krijimin e fondit të përbashkët në mbështetje të Luginës së Preshevës, nënshkruar dhe hyrë në fuqi më 2.10.2020.<br><br>4. Marrëveshje për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Integrimit Evropian Të Republikës së Kosovës për mbështetjen e ndërsjelle në kuadër të përgatitjes për hapjen e negociatave të pranimit, nënshkruar më 23.04.2020.<br><br>5. Protokoll zbatues në fushën e diplomacisë kulturore ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës, nënshkruar më 23.04.2020.<br><br>6. Protokoll bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës për zbatimin e marrëveshjes për bashkëpunim strategjik në fushën e politikës së jashtme për përfaqësimin e interesave të përbashkëta diplomatike, nënshkruar më 23.04.2020.<br><br>7. Marrëveshja ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës mbi bashkëpunimin strategjik në fushën e politikës së jashtme, nënshkruar më 2.7.2019, hyrë në fuqi më 18.9.2019.<br><br>8. Marrëveshje Bashkëpunimi Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, nënshkruar më 27.11.2017, hyrë në fuqi më 19.2.2018.<br><br>9. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për financimin dhe organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë, nënshkruar më 27.11.2017. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 10. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e Diasporës, nënshkruar më 27.11.2017.<br><br>11. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për qendrat kulturore në Diasporë, nënshkruar më 27.11.2017.<br><br>12. Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Akademisë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Akademisë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, nënshkruar në Tiranë, më 6.1.2016.<br><br>13. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë në Tiranë e Prishtinë dhe British Council në kuadër të bashkëpunimit për zbatimin e projektit "Projekti për diplomaci digjitale–Shqipëria dhe Kosova digjitale", nënshkruar më 14.12.2015.<br><br>14. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Integrimit Evropian të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Integrimit Evropian të Republikës së Kosovës për krijimin e Komisionit Teknik për përkthimin e legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe, si dhe bashkëpunimit në sferën e përafrimit të legjislacionit, nënshkruar më 26.3.2014 dhe hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.<br><br>15. Protokoll Veprimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës në lidhje | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | me përfaqësimin konsullor të Republikës së Shqipërisë në Kanbera dhe Republikës së Kosovës në Milano, nënshkruar në Prishtinë, më 14.3.2014, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.<br><br>16. Deklarata e Përbashkët për bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, e nënshkruar në Prizren, më 11.1.2014.<br><br>17. Protokolli i sesionit të Parë të Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar për bashkëpunimin Kosovë–Shqipëri, nënshkruar në Tiranë, më 15.3.2013, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.<br><br>18. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e përfaqësimit konsullor, nënshkruar më 13.1.2012, hyrë në fuqi më 26.4.2012.<br><br>19. Protokoll bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, nënshkruar më 25.11.2009. | | |
| 42. | 19.10.2022 | Sa nota verbale për fillimin e hetimeve ndaj konsujve të nderit të Republikës së Shqipërisë i janë dërguar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme ose konsullatave shqiptare që nga viti 2000? Cilat vende i kanë dërguar këto nota verbale? 2. Sa nota verbale për fillimin e hetimeve ndaj konsujve të | 25.10.2022 | Ne pergjigje Tuajes, ju bëjmë me dije si vijon<br><br>Nga verifikimet e kryera ne dosjet e viteve që ceken në kërkesë, rezulton se nuk kemi pasur asnjë kërkesë te tille te përcjellë me note verbale nga shtetet e huaja kundrejt Konsujve te Nderit te Republikës së Shqipërisë të emëruar jashtë, po ashtu edhe e kundërta. | E plotë | Pa tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nderit ka dërguar Shqipëria që nga viti 2000? Cilat janë vendet që i janë dërguar këto nota verbale? | | | | |